



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ (Projekt)

Nr. _____ , Datë _____._____.2024

**PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 64/2012 “PËR PESHKIMIN”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin të Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 4 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës 2 shtohet pikat 2/1 si më poshtë:

“2/1. “anije mbështetëse” nënkupton një anije të ndryshme nga një mjet lundrues i mbajtur në bord, e cila nuk është e pajisur me vegla peshkimi të gatshme për tu përdorur, të projektuara për të zënë ose tërhequr peshq dhe që përdoret për të lehtësuar, ndihmuar ose përgatitur operacionet e peshkimit.”

2. Pika 22/1 riformulohet si më poshtë:

“22/1. Infrastruktura e peshkimit” janë portet, qendrat e peshkimit, vendzbakimet dhe tërësia e trojeve, kalatave, godinave, përfshirë muret rrethuese të porteve dhe akuatoriumin, instalimet e sinjalizimit, të ndriçimit dhe të komunikimit.

3. Pika 22/2 riformulohet si më poshtë:

“22/2. Infrastruktura që lidhet me peshkimin përfshin, markatat, tregun e shitjes me shumicë, linjat teknologjike, asetet e lidhura, shkallët e riparimit të anijeve të peshkimit, depozitat e karburantit, pasuritë e luajtshme dhe çdo pasuri ose objekt tjetër që i shërbenë peshkimit, pavarësisht emërtesës në inventar”.

4. Pas pikës 38 shtohet pika 38/1 si më poshtë:

“38/1. “Masat e ruajtjes dhe menaxhimit” nënkuptojnë masat për të ruajtur dhe menaxhuar një ose më shumë lloje të burimeve të gjalla ujore dhe që janë miratuar dhe janë në fuqi në përputhje me rregullat përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtar”.

5. Pas pikës 41 shtohet pika 41/1 me këtë përmbajtje:

“41/1. “Markatë ose treg shitje me shumicë” është një treg, qendër ankandi, ose strukture tjetër e përherhme ose e përkohshme e cila përdoret për tregtimin me shumicë të produkteve të peshkut.”

6. Pas pikës 57, shtohen pikat 57/1 dhe 57/2, me këtë përmbajtje:

“57/1. “*Pendë peshkaqeni*” është çdo pendë peshkaqeni, përfshirë këtu edhe pendën kaudale por duke përjashtuar pendët pektorale të rajave.

“57/2. “*Peshkaqen*” është çdo peshk që bën pjesë në klasën *Elasmobranchii*.”

7. Pika 62 riformulohet si më poshtë:

“62. “Peshkim tregtar profesional” është ajo kategori e peshkimit detar që ushtrohet nga anije me gjatësi më të madhe se 12 metra dhe me fuqi motorike të barabartë dhe/ose më të madhe se 56 KW (75 kuaj-fuqi), që përdorin rrjeta me tërheqje (fundore dhe pelagjike, veçmas ose së bashku), rrjeta me rrethim, draga hidraulike dhe linje grepash (pallangare).”

8. Pika 63 riformulohet si më poshtë:

“63. “Peshkim tregtar artizanal ose peshkim bregdetar artizanal” është peshkimi tregtar që zhvillohet nga mjetet lundruese që përdorin çdo lloj vegle tjetër peshkimi të ndryshme nga ato që përdoren në peshkimin tregtar profesional.”

9. Pas pikës 70, shtohet pika 70/1 si më poshtë:

“70/1. “Popullata ndërzonale” janë popullata peshqish që gjenden brenda Zonës Ekskluzive Ekonomike ose të një zone ngjitur me të.”

10. Pika 108 riformulohet si më poshtë:

“108. “Zonë e kufizuar e peshkimit” është një zonë detare specifike e përcaktuar gjeografikisht brenda një ose më shumë baseneve detare ku të gjitha ose disa aktivitete peshkimi janë të kufizuara ose të ndaluara përkohësisht ose përgjithmonë me qëllim përmirësimin e ruajtjes së burimeve biologjike të gjalla ose mbrojtjen e ekosistemeve detare sipas përcaktimeve të legjislacionit të peshkimit.”

11. Pika 110 riformulohet si më poshtë:

“110. “Zonë e mbrojtur peshkimi” është një zonë ku nuk lejohet asnjë lloje aktiviteti peshkimi.”

Neni 2

Kudo në ligj togfjalëshi “zonë e mbrojtur” zëvendësohet me togfjalëshin “zonë e kufizuar” me përjashtim të nenit 12 dhe togfjalëshi “inspektorati që mbulon fushën e inspektimit” zëvendësohet me togfjalëshin “inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”.

Neni 3

Neni 5 shfuqizohet.

Neni 4

Neni 23 riformulohet si më poshtë:

“Neni 23 Politikat e peshkimit

1. Politikat e peshkimit në Republikën e Shqipërisë përcaktohen dhe zbatohen në përputhje me strategjinë kombëtare të peshkimit.
2. Objektivat e politikës së peshkimit kanë për qëllim:
 - a. sigurimin që aktivitetet e peshkimit të jenë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore në periudhë afatgjatë dhe menaxhimin në përputhje me objektivat e arritjes së përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, si dhe për të kontribuar në disponueshmërinë e furnizimeve ushqimore.
 - b. qasjen e kujdesshme të menaxhimit të peshkimit që synon të sigurojë që shfrytëzimi i burimeve të gjalla biologjike detare të rindërtojë dhe të mbajë popullatat e specieve të peshkuara mbi nivele të afta për të prodhuar rendimentin maksimal të qëndrueshëm.
 - c. zbatimin e qasjes së bazuar në ekosistemin për menaxhimin e peshkimit për të siguruar që aktivitetet e peshkimit të kenë një ndikim minimal në ekosistemet detare dhe që siguron që aktivitetet e peshkimit të shmangin degradimin e mjedisit detar.
 - ç. Grumbullimin e të dhënave shkencore.
 - d. Në mënyrë të veçantë të:
 - i. eliminojnë gradualisht hedhurinat bazuar në këshillat më të mira shkencore të disponueshme, duke shmangur dhe reduktuar, për aq sa është e mundur, zëniet aksidentale dhe duke siguruar në mënyrë progresive që ato të zbarkohen;
 - ii. kur është e nevojshme, të bëjnë përdorimin më të mirë të mundshëm të zënieve aksidentale, pa krijuar një treg për këto zënie të cilat janë nën madhësinë minimale të referencës;
 - iii. krijojnë kushtet e nevojshme për ta bërë sektorin e peshkimit dhe përpunimit dhe aktivitetet në tokë që lidhen me aktivitetet e peshkimit, ekonomikisht të qëndrueshme dhe konkurruese;

- iv. parashikojnë masa për të përshtatur kapacitetin e peshkimit të flotës me nivelet e mundësive të peshkimit, në mënyrë që të ketë një flotë ekonomikisht të qëndrueshme pa mbishfrytëzuar burimet biologjike detare;
 - v. promovojnë zhvillimin e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës për të kontribuar në furnizimin me ushqim dhe sigurinë ushqimore si dhe punësimin;
 - vi. kontribuojnë në sigurimin e një standardi të drejtë jetese për ata që varen nga aktivitetet e peshkimit, duke marrë parasysh peshkimin bregdetar dhe aspektet socio-ekonomike;
 - vii. kontribuojnë në një treg të brendshëm efikas dhe transparent për produktet e peshkimit dhe akuakulturës dhe për të siguruar një mjedis të barabartë për produktet e peshkimit dhe akuakulturës që tregtohen në Shqipëri;
 - viii. të marrë parasysh interesat e konsumatorëve dhe të prodhuesve;
 - ix. promovojnë aktivitetet e peshkimit bregdetar, duke marrë parasysh aspektet socio-ekonomike;
 - x. të jetë në përputhje me legjislacionin mjedisor, veçanërisht me objektivin e arritjes së statusit të mirë mjedisor siç parashikohet në ligjin për strategjinë e mbrojtjes së mjedisit detar.
3. Në zbatim të politikës së peshkimit:
- a. Masat e ruajtjes dhe menaxhimit të burimeve biologjike detare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - b. Masat për menaxhimin e flotës që shfrytëzon burimet biologjike detare miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - c. Përfshirja e institucioneve të tjera në marrjen dhe zbatimin e masave menaxhuese të burimeve biologjike detare miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Në nenin 30 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si më poshtë:

“1/1. Një anije peshkimi mund të përdoret për shfrytëzim tregtar të burimeve të gjalla ujore vetëm nëse ka një leje të vlefshme peshkimi”.

- b) Pika 11 e nenit 30 ndryshon dhe riformulohet si më poshtë:

“11. Leje të reja peshkimi jepen vetëm për anije peshkimi:

- a) me kapacitet peshkimi (prodhimi i tonazhit me fuqinë motorike) më të vogël ose të barabartë me një anije peshkimi me leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj;
- b) të mbytura, të cilat ishin të pajisura me një leje të vlefshme peshkimi në kohën e ngjarjes, si zëvendësim i saj. Në këtë rast kërkesën për leje peshkimi e bën pronari i anijes ose trashëgimtarët e tij.

c) të rrëmbyera të cilat ishin të pajisura me leje të vlefshme peshkimi në kohën e ndodhjes së ngjarjes. Subjekt i këtij zëvendësimi janë anijet e rrëmbyera pas vitit 2011.

d) që ushtrojnë aktivitetet peshkimi në detet e hapura, jashtë detit Mesdhe”.

c) Pas paragrafit 11 shtohet paragrafi 12 me këtë përmbajtje:

“12. Rregullat dhe procedurat për zëvendësimin e anijeve të peshkimit miratohen me udhëzim të ministrit.”

Neni 6

Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 30/1

Peshkimi në detet e hapura

1. Leja e peshkimit në det të hapur lëshohet vetëm në rastet kur:
 - a. anija e peshkimit ka kapacitet për të lundruar në det të hapur të vërtetuar nga shoqëria klasifikuese që vepron në emër të administratës detare.
 - b. është marrë informacion, në përputhje me Organizatën(at) Rajonale të Menaxhimit të Peshkimit (ORMP) në zonën përkatëse dhe informacion për të dhënat e anijes së peshkimit dhe anijen e saj mbështetëse, nëse ka.
 - c. anija e peshkimit dhe çdo anije mbështetëse e lidhur me të, nëse ka, është e pajisur me numrin e identifikimit IMO;
 - d. anija e peshkimit nuk përfshihet në listën e anijeve PPP të miratuar nga një ORMP nga Bashkimi Evropian, dhe nga Republika e Shqipërisë.
 - e. anija ka një gjatësi të përgjithshme mbi 24 metra.
2. Rregullat për lëshimin e lejes për peshkim në det të hapur miratohen me udhëzim ministri.
3. Lejet e peshkimit në det të hapur ndalon zëniet e llojeve shumë migruese dhe llojet ndërzonale.”

Neni 7

Neni 34 riformulohet si me poshtë:

“Neni 34

Peshkimi jashtë ujërave territoriale

E drejta e peshkimit jashtë ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, përcaktohet në lejen e peshkimit tregtar, lëshuar nga ministri.”

Neni 8

Në nenin 34/1, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 riformulohet si me poshtë:

“1. Anijet e peshkimit bregdetar artizanal mund të jenë të përfshira në një nga format e organizimit të përcaktuara në pikën 1, të nenit 58, të këtij ligji, me qëllim bashkërendimin dhe menaxhimin e peshkimit artizanal në shkallë të vogël.”

b) Pika 3 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 37, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Shkronja “d” riformulohet si më poshtë:

“d. peshkaqenët dhe rajat - *Cetorhinus maximus*, *Carcharodon Carcharias*, *Squatina squatina*, *Hexanchus griseus*, *Rostroraja alba*, gjinia *Pristidae*, familja *Rhinobatidae*, *Alopiidae*; *Carcharhinidae*; *Sphyrnidae*; *Lamnidae*;”

b) Shkronja “dh” ndryshohet si më poshtë:

“dh) lopa e detit - gjinia *Mobula*;”

c) Pas shkronjës “h” shtohet shkronja “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

“i. molusqe bivalvore - *Pinna nobilis*, *Pholas dactylus*”

“j. iriq deti - *Centrostephanus longispinus*”

2. Pas pikës 1, shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 me këtë përmbajtje:

“1/1 Ndalohen heqja e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijes, mbajtja në bord, trasbordimi, zbarkimi i qëllimtë i këtyre pendëve”

“1.2 Ndalohet shitja dhe hedhja në treg e pendëve të peshkaqenëve që janë hequr në kundërshtim me pikën 1/1 të këtij neni”

“1/3 Në përjashtim të pikës 1/1, me qëllim lehtësimin e procedurave të ruajtjes dhe magazinimit në bord, lejohet prerja e pjesshme dhe palosja e pendëve të peshkaqenëve.”

Neni 10

Në nenin 61/1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a. Në fund të shkronjës d) të pikës 2 shtohet togfjalëshi “nëpërmjet planeve të prodhimit dhe marketingut.”

b. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Forma dhe përmbajtja e planeve të prodhimit dhe marketingut miratohen me vendim të Këshill të Ministrave.”

Neni 11

Neni 64 riformulohet si vijon

“Neni 64

Transferimi i menaxhimit të infrastrukturës tek organizatat e peshkimit

1. Organizata e peshkimit që plotëson kushtet e nenit 62 të këtij ligji merr në menaxhim infrastrukturën e peshkimit.
2. Organizata e peshkimit menaxhon infrastrukturën e peshkimit në përputhje me parimet e mëposhtme:
 - a) përballimi i kostove të përdorimit e të mirëmbajtjes;
 - b) aksesit të barabartë, për të nxitur dhe mbrojtur interesat e përdoruesve;
 - c) në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit
 - ç) zhvillimit të qëndrueshëm.
3. Në rastin kur infrastruktura e peshkimit menaxhohet nga një organizatë peshkimi, veprohet si më poshtë:
 - a) çdo mjet lundrues peshkimi, që është pronë ose drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, lejohet të përdorë portin ose qendrën e peshkimit që i është transferuar organizatës;
 - b) personat, të cilët nuk janë anëtarë të organizatës, lejohen të hyjnë në port ose në qendrën e peshkimit;
 - c) çdo person, i cili hyn ose shfrytëzon portin apo qendrën e peshkimit që i është transferuar një organizatë dhe që nuk është anëtar i saj, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e portit ose të qendrës së peshkimit dhe me rregulloret e organizatës;
 - ç) tarifat që organizata ofron për shërbimet për një mjet lundrues, që është pronë a drejtohet nga një person, i cili nuk është anëtar i organizatës, janë më të larta se tarifat për mjetet lundruese të anëtarëve të saj, por, në çdo rast, jo më shumë se dyfishi i tyre.
4. Tarifat miratohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për peshkimin dhe ministrit përgjegjës për financat pas konsultimit me organizatën e peshkimit.”

Neni 12

Titulli i kreut VIII ndryshohet si vijon :

“Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin”

Neni 13

Neni 65 riformulohet si vijon:

“Neni 65

Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin

1. Institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës menaxhon në mënyrë të drejtpërdrejtë infrastrukturën e peshkimit dhe të lidhur me peshkimin, dhe kryen procedurat e transferimit të menaxhimit të tyre.
2. Menaxhimi i infrastrukturës së lidhur me peshkimit transferohet tek njëësia e vetëqeverisjes vendore, nen juridiksionin territorial e se cilës ndodhet kjo infrastrukture e lidhur me peshkimin.
3. Në rast se njëësia e vetëqeverisjes vendore nuk shpreh interes për menaxhimin e infrastrukturës së lidhur me peshkimin, kjo infrastrukture i transferohet me konkurrim publik subjekteve tregtare.
4. Përcaktimi i kriterëve, procedura, mënyra e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur të peshkimit dhe formati tip i kontratës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 14

Në nenin 69 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 riformulohet si më poshtë:

“ 1. Një anije peshkimi me flamur shqiptar që kryen aktivitet në ujërat shqiptare autorizohet të kryejë aktivitete të veçanta peshkimi vetëm për aq sa ato tregohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi kur peshkimi ose zonat e peshkimit ku autorizohen aktivitetet i nënshtrohen:

- (a) një regjimi sforcoje peshkimi;
- (b) një plani shumëvjeçar;
- (c) një zone të kufizuar peshkimi
- (d) peshkimit për qëllime shkencore;ose
- (e) raste të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar.

b) Pika 2, shfuqizohet.

Neni 15

Në nenin 72 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si më poshtë vijon:

“ 1/1. Ministria ngre një sistem monitorimi të anijeve me bazë satelitore për monitorimin efektiv të aktiviteteve të peshkimit të anijeve të peshkimit me flamur shqiptar kudo që mund të jenë ato anije dhe të aktiviteteve të peshkimit të këtyre anijeve në ujërat ndërkombëtare”.

b) Pika 3 riformulohet si me poshtë:

“3. Ministria siguron që të dhënat e siguruar nga sistemi automatik i identifikimit në anijet e peshkimit i transmetohen QNOD-së dhe Inspektoratit të Peshkimit.”

c) Pas pikës 8 shtohen pikat 8/1 dhe 8/2 si më poshtë vijon:

“8/1. Një anije peshkimi me gjatësi të barabartë ose më të madhe se 15 metra duhet të pajiset dhe të mbajë në funksion një sistem automatik identifikimi (AIS) i cili plotëson standardet e performancës të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO)

8/2. Ministria përdor të dhënat e sistemit të identifikimit automatik, kur të dhënat e tilla janë të disponueshme, për qëllime të kryqëzimit me të dhënat e tjera të disponueshme.

d) Në pikën 9, togfjalëshi “i pikës 1” zëvendësohet me togfjalëshin “i pikave 1 dhe 8/1”

Neni 16

Në nenin 73, pas togfjalëshit “me sistem monitorimi” shtohet “satelitor,”.

Neni 17

Në pikën 1 të nenit 81 togfjalëshi “të paktën 24 orë para mbërritjes së tyre” zëvendësohet me togfjalëshin “të paktën 3 (tre) ditë pune përpara momentit të parashikuar të mbërritjes në port”.

Neni 18

Ne nenin 109 pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit e tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 19

Ne nenin 118, pika 3 riformulohet si me poshtë:

“3. Përcaktimi i rregullave të inspektimit për parandalimin, reduktimin dhe eliminimin e peshkimit të paligjshëm, të paraportuar dhe të parregulluar dhe skema e certifikimit të zënieve në peshkimi miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 20

Në nenin 121 bëhen këto ndryshime:

a) pika 3 shfuqizohet

2 pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Manuali i detyrave dhe përgjegjësi të inspektorëve për peshkimin hartohet nga institucioni përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën në bashkëpunim me inspektoratin shtetëror dhe miratohet nga ministri.”

Neni 21

Neni 127 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 127

Subjektet përgjegjëse të kundërvajtjeve administrative

1. Çdo subjekt peshkimi është përgjegjës për shkeljet e rënda kur ato janë kryer në dobi të tij nga çdo person që vepron individualisht ose si pjesë e një organi të subjektit të peshkimit, i cili mban një pozitë dominuese brenda subjektit-për shkak të:
 - a) Kompetencave të përfaqësimit të subjektit në fjalë; ose
 - b) kompetencave për të marrë vendime në emër të subjektit ose
 - c) të ushtrimit të kontrollit brenda atij subjekti.
2. Çdo subjekt peshkimi është përgjegjës edhe kur mungesa e mbikëqyrjes ose kontrollit nga një person i përmendur në pikën 1 të këtij neni ka bërë të mundur që një person në vartësi të tij të kryejë një nga shkeljet e rënda në dobi të subjektit të peshkimit në fjalë.
3. Përgjegjësia e subjektit të peshkimit nuk përjashton mundësinë e marrjes së masave ndaj personave që janë autorë, nxitës ose bashkëpunëtorë të shkeljeve të konsideruara”

Neni 22

Neni 128 riformulohet si më poshtë vijon:

“Neni 128

Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbejnë kundërvajtje administrative shkeljet e mëposhtme:
 - a. Hedhja e mbeturinave të lëngshme apo të ngurta që krijojnë efekte negative në cilësinë e mjedisit ujor, në kundërshtim me dispozitat e shkronjës “a” të nenit 7 të këtij ligji, dënohet sipas legjislacionit në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit.
 - b. Lëshimi i llojeve të peshkut jointdigjenë dhe/ose organizmave të tjerë ujorë, llojeve të peshkut të modifikuara gjenetikisht ose organizmave të tjerë ujorë, në kundërshtim me dispozitat e shkronjës “b” të nenit 7 të këtij ligji, në hapësirën detare dhe në ujëra të brendshme, dënohet me gjobë në masën 300 000 lekë.
 - c. Aktivitetet nënujore, që synojnë peshkimin në vende ku nuk është marrë më parë leje prej autoritetit menaxhues përgjegjës, në kundërshtim me dispozitat e shkronjës “c” të nenit 7 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 30 000 lekë.

- d. Zënia e të vegjëlve, llojeve të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë të paarrirë për t'u riprodhuar ose me përmasa më të vogla se ato të parashikuara në aktet nënligjore, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, dënohet me gjobë nga në masën 100 000 lekë deri 1 000 000 lekë si dhe sekuestrimin e prodhimit të peshkuar nën dimension.
- e. Ushtrimi i aktivitetit të peshkimit dhe marrja ose shkatërrimi i faunës dhe florës në zonat e mbrojtura ujore, në kundërshtim me dispozitat e shkronjave "a" dhe "b" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohen me gjobë në masën 500 000 lekë.
- f. Hedhja apo shfrytëzimi i rërës ose zhavorrit, shkarkimi apo zhvendosja e ujërave apo çdo materiali tjetër ndotës, si edhe ndërhyrja, prishja apo shkatërrimi i mjedisit në zonat e mbrojtura ujore, në kundërshtim me dispozitat e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohen me gjobë, në masën nga 400 000 lekë deri në 2 000 000 lekë.
- g. Ndërtimi i strukturave në tokë apo në ujë në kundërshtim me dispozitat e shkronjës "ç" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 600 000 lekë deri në 3 000 000 lekë.
- h. Ndërmarrja apo kryerja e aktiviteteve të tjera që mund të kenë një ndikim negativ mbi ekosistemin e zonës së mbrojtur në kundërshtim me dispozitat e shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën nga 200 000 lekë deri në 1 000 000 lekë.
- i. Zënia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë në kundërshtim me urdhrin për ndalimin e peshkimit, jashtë sezonit apo në zonat ku nuk lejohet peshkimi, në kundërshtim me dispozitat e neneve 13 dhe 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën nga 200 000 lekë deri në 1 000 000 lekë, dhe shoqërohet me sekuestrimin e produkteve të peshkuara.
- j. Zënia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë me eksplozivë, substanca kimike ose çdo mënyrë tjetër që vret, intoksikon apo helmon, në kundërshtim me dispozitat e pikës 1 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 1 000 000 lekë deri në 5 000 000 lekë.
- k. Mbajtja në bord apo në breg e eksplozivëve apo substancave kimike që vrasin, helmojnë apo intoksikojnë peshkun dhe organizmat e tjerë ujorë, në kundërshtim me dispozitat e pikës 2 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën 1 500 000 lekë
- l. Përdorimi dhe mbajtja në anije e substancave apo pajisjeve, sipas pikës 3 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në masën nga 500 000 lekë deri në 2 500 000 lekë.
- m. Shkelja e nenit 16 pika 4 të këtij ligji dënohet me gjobë në masën 5 000 lekë.
- n. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit në kundërshtim me dispozitat e nenit 16 pikat 5 e 6 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën 500 000 lekë;
- o. Ushtrimi i aktivitetit të peshkimit, pa qenë i pajisur me leje apo në kundërshtim me kushtet e parashikuara në të, sipas dispozitave të nenit 30 të këtij ligji, dënohet me gjobë dhe sekuestrim të produkteve të peshkuara:
 - i. Në masën 200 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet në kundërshtim me kushtet e parashikuara në leje

- ii. Në masën 1 000 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet pa qene i pajisur me leje.
- p. Shkelja e dispozitave të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën 50 000 lekë.
- q. Shkelja e dispozitave të nenit 34 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, në masën 250 000 lekë.
- r. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit prej një anijeje të huaj në ujërat e Republikës së Shqipërisë, dënohet me gjobë, në masën nga 3 000 000 lekë në 5 000 000 lekë si dhe sekuestrohen produktet e peshkuara. Shpenzimet e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së anijes së bllokuar përballohen nga kundërvajtësi.
- s. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit prej një anijeje me flamur të huaj në Zonën Ekskluzive Ekonomike të Republikës së Shqipërisë pa qenë e pajisur me leje për këtë qëllim, dënohet me gjobë, në masën nga 200 000 lekë në 600 000 lekë. Anija e peshkimit qëndron e bllokuar deri në pagesën e plotë të gjobës së vendosur. Shpenzimet e ruajtjes dhe mirëmbajtjes së anijes së bllokuar përballohen nga kundërvajtësi.
- t. Peshkimi, mbajtja në bord, transitimi në barkë dhe anije, zbarkimi i qëllimtë dhe hedhja në treg ose për konsum e llojeve të mbrojtura të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë, në kundërshtim me dispozitat e pikës 1 të nenit 37 të këtij ligji dënohen me gjobë, në masën nga 100 000 lekë deri në 1 000 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrimin produkteve (llojet e mbrojtura).
- u. Heqja e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijes, mbajtja në bord, trasbordimi, zbarkimi i qëllimtë, shitja dhe hedhja në treg të këtyre pendëve, në kundërshtim me dispozitat e pikave 1/1 dhe 1/2 të nenit 37 të këtij ligji dënohen me gjobë, në masën nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrimin e produktit (pendëve të peshkaqenëve).
- v. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit çlodhës - argëtues në kundërshtim me dispozitat e nenit 38 pika 2 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën 5 000 lekë
- w. Mbledhja dhe/apo tregtia e peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë të zënë me eksplozivë, substanca kimike ose çdo mënyrë tjetër që vret, intoksikon apo helmon, dënohet me gjobë, në masën nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë dhe shoqërohet me sekuestrim të produkteve.
- x. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit amator, pa qenë i pajisur me autorizimin përkatës ose në kundërshtim me dispozitat e neneve 40 e 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën 5 000 lekë
- y. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit turistik, pa qenë i pajisur me autorizimin përkatës ose në kundërshtim me dispozitat e neneve 40 e 42 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën 50 000 lekë.
- z. Ushtrimi i veprimtarisë së peshkimit çlodhës - argëtues në kundërshtim me dispozitat e nenit 45 të këtij ligji, dënohet me gjobë:
 - i. në masën 5 000 lekë pa mjet lundrues;

- ii. në masën 50 000 lekë në rast se për kryerjen e shkeljes përdoret mjet lundrues.
- aa. Cilido, që zhvillon veprimtari studimore dhe shkencore pa autorizimin, sipas nenit 49 të këtij ligji ose në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në autorizim, dënohet me gjobë:
 - i. në masën 100 000 lekë në rast se veprimtaria studimore dhe shkencore zhvillohet në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në autorizim;
 - ii. në masën 300 000 lekë në rast se veprimtaria studimore dhe shkencore zhvillohet pa autorizim.
- bb. Ushtrimi i peshkimit, pa qenë i pajisur me autorizim apo në kundërshtim me kushtet e parashikuara në të, sipas dispozitave të nenit 69 të këtij ligji, dënohet me gjobë dhe shoqërohet me sekuestrimin e produkteve të peshkuara:
 - i. në masën 200 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet në kundërshtim me kushtet e parashikuara në autorizim
 - ii. në masën 1 000 000 lekë nëse aktiviteti i peshkimit ushtrohet pa qenë i pajisur me autorizim
- cc. Mosshënjimi i mjeteve lundruese dhe veglave të peshkimit, sipas nenit 70 të këtij ligji, dënohet me gjobë:
 - i. në masën 5 000 lekë për mos shënjimin e veglave të peshkimit
 - ii. në masën 10 000 lekë për mosshënjimin e mjeteve lundruese
- dd. Mosinstalimi i pajisjeve ose dëmtimi i tyre, sipas pikës 1 të nenit 72 të këtij ligji dënohet me gjobë:
 - i. manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit të tyre për një periudhë të caktuar kohe në masën 500 000 lekë
 - ii. nxjerrja jashtë përdorimit përfundimisht në masën 1 000 000 lekë si dhe ndalimin e aktivitetit të peshkimit të mjetit lundrues në fjalë deri në bërjen funksionale të pajisjeve. Shpenzimet e riparimit ose zëvendësimit të tyre përballohen nga kundërvajtësi.
- ee. Mosinstalimi, dëmtimi, manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit për një periudhë të caktuar kohe i pajisjeve sipas pikës 8/1 të nenit 72 të këtij ligji dënohet me gjobë:
 - i. Mosinstalimi në masën 200 000 lekë
 - ii. Manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit për më pak se 2 (dy) orë, në masën 100 000 lekë
 - iii. Manipulimi, shuarja ose nxjerrja jashtë përdorimit për mbi 2 (dy) orë, në masën 500 000 lekë.
- ff. Mosrespektimi i detyrimeve në lidhje me regjistrimin dhe deklarimin e të dhënave në lidhje me zëniet ose të dhënave të lidhura me to në librin e anijes, të regjistrimit elektronik, të lajmërimit paraprak, dhe deklaratën e zbarkimit, sipas detyrimeve të neneve 74 deri 82 të këtij ligji, dënohen me gjobë, në masën 5 000 lekë për çdo regjistrim dhe deklarim të mos realizuar sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në nenet 74 deri 82 të këtij ligji.
- gg. Mosrespektimi i detyrimeve, sipas nenit 83 të këtij ligji, në lidhje me deklaratën e zbarkimit, dënohet me gjobë, në masën nga 5 000 lekë deri në 10 000 lekë.

- hh. Peshkimi mbi normat e lejuara në zonat e peshkimit, për të cilat ka një regjim të përcaktuar peshkimi, si dhe shkelja e procedurave dhe dispozitave të përcaktuara në nenet 88 deri 90 të këtij ligji, dënohen me gjobë, në masën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, si dhe shoqërohet me sekuestrimin e sasive mbi kuotat e lejuara.
 - ii. Shkeljet nga ana e anijeve të peshkimit që nuk janë të pajisura me sistemin e monitorimit në anije apo që nuk transmetojnë të dhënat e librit të anijes së peshkimit dhe që janë subjekt i një regjimi sforcoje peshkimi të dispozitave të përcaktuara në nenet 91 dhe 92 të këtij ligji, dënohen me gjobë, në masën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.
 - jj. Transbordimi i zënieve nga një anije në tjetrën, në porte ose vende të pa miratuara, sipas përcaktimeve të nenit 99 të këtij ligji dhe në kundërshtim me nenin 98 të këtij ligji, dënohet me gjobë, në masën nga 10 000 lekë deri në 50 000 lekë.
 - kk. Përdorimi i një fuqie tjetër motorike, zëvendësimi i saj me një tjetër motor me tjetër fuqi apo përdorimi i një fuqie tjetër të modifikuar teknikisht, kur kjo e fundit nuk është certifikuar zyrtarisht nga shoqëria klasifikuese që vepron në emër të administratës detare, në shkelje të nenit 102 të këtij ligji, dënohen me gjobë, në masën 50 000 lekë.
 - ll. Shkeljet e dispozitave të neneve 105 dhe 106 të këtij ligji dënohen me gjobë, në masën 100 000 lekë, si dhe shoqërohet me kontrollin e anijes së peshkimit në daljen e saj më të parë në port.
 - mm. Shkelja e dispozitave të nenit 107 të këtij ligji dënohet me gjobë, në masën 100 000 lekë.
 - nn. Shkelja e dispozitave të nenit 108 të këtij ligji dënohet me gjobë, në masën 50 000 lekë.
 - oo. Mosparaqitja e certifikatës së origjinës së produkteve peshkore, me qëllim identifikimin e zonës përkatëse të origjinës nga operatorët përgjegjës për zënien, shitjen, magazinimin ose transportimin e tyre, në shkelje të pikës 2 të nenit 109 të këtij ligji, si dhe shkelja e dispozitave të pikës 1 të nenit 110 dhe të pikës 1 të nenit 111 të këtij ligji, dënohen me gjobë, në masën nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë, si dhe shoqërohet me sekuestrim të produkteve.
 - pp. Hedhja në treg, importi ose eksporti i prodhimeve peshkore nga peshkimi PPP, për rastet e tjera të paparashikuara në pikat e mësipërme të këtij neni, përbëjnë shkelje, të cilat dënohen me gjobë sa pesëfishi i vlerës së prodhimeve peshkore, si dhe sekuestrimin e tyre.
 - qq. Përdorimi i mjeteve të peshkimit (veglave) jo të autorizuara ose në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në shkelje të shkronjës ë) të nenit 117 të këtij ligji dënohen me gjobë, në masën nga 100 000 lekë deri në 500 000 lekë, si dhe shoqërohet me sekuestrimin e këtyre mjeteve (veglave) të peshkimit.
2. Procedurat e ekzekutimit të gjobave bëhen në përputhje me dispozitat në fuqi për kundërvajtjet administrative.
 3. Në rast se shkeljet janë kryer nga mjete lundruese të peshkimit tregtar artizanal, në bregdet dhe ujëra të brendshme, aplikohet gjysma e masës të parashikuar në pikën 1) të këtij neni.

4. Në rast të përsëritjes të së njëjtës shkelje brenda një periudhe 6 mujore nga shkelja e mëparshme, për shkeljen e re aplikohet dyfishi i vlerave të gjobave të përcaktuara në pikën 1) të këtij neni.
5. Në rast se gjatë shkeljeve janë zënë specie shumë migratore si toni i kuq (*Thunnus thynnus*) dhe peshku shtize (*Xiphias gladius*), aplikohet dyfishi i masës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni.
6. Ministri miraton metodologjinë e hartuar nga inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit, persa i përket përcaktimin e masës administrative për shkeljet e listuar ne pikën 1) te këtij neni.

Neni 23

Neni 131 riformulohet si më poshtë:

“Neni 131

Ankimi

1. Ankimi ndaj vendimit të inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit për marrjen e masave urgjente, dënimin me gjobë dhe vendosjes e dënimeve plotësuese bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin dhe paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të masës administrative.
2. Ankimi ndaj vendimit për dhënien e miratimit ose mosmiratimit për lejen e peshkimit paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.”

Neni 24

Neni 132 riformulohet si më poshtë:

“Neni 132

Komisioni për Shqyrtimin e Ankimimeve

1. Për shqyrtimin e ankesave ndaj masave administrative të marra nga inspektorët e peshkimit, gjatë kryerjes së një inspektimit dhe për shqyrtimin e ankesave për lejet e peshkimit, në ministri ngrihet Komisioni për Shqyrtimin e Ankimimeve, në përbërje të të cilit janë pesë anëtarë.
2. Ngritja, përbërja dhe funksionimi i Komisionit për Shqyrtimin e Ankimimeve miratohet me urdhër ministri.”

Neni 25

Dispozitë kalimtare

Pika 8/1 e nenit 72 zbatohet:

- a) Duke filluar nga data 1 janar 2025 për anijet e peshkimit me gjatësi mbi 24 metra;
- b) Duke filluar nga data 1 qershor 2025 për anijet e peshkimit me gjatësi 18-24 metra;
- c) Duke filluar nga data 1 janar 2026 për anijet e peshkimit me gjatësi 15-18 metra.

Neni 26

Në nenin 135 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të shkronjave a) dhe b) të nenit 23, të pikës 2/1 të nenit 61/1, pikës 4 të nenit 65 dhe pikës 4 të nenit 109 brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”

2. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ngarkohet ministri përgjegjës për peshkimin për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të pikës 12 të nenit 30, të pikës 2 të nenit 30/1, të pikës 4 të nenit 121, të pikës 6 të nenit 128 dhe të pikës 2 të nenit 132 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”

Neni 27

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

LINDITA NIKOLLA

Miratuar, me ____ . ____ .2024